

VENDIM
Nr. 128, datë 11.2.2015

PËR CAKTIMIN E DISA ANËTARËVE TË BORDIT TË AUTORITETIT
KOMBËTAR TË USHQIMIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 64, të ligjit nr.9863, datë 28.1.2008, “Për ushqimin”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Caktimin e anëtarëve të bordit të Autoritetit Kombëtar të Ushqimit, sipas shkronjave “dh”, “ë”, “p” dhe “g”, të pikës 2, të nenit 64, të ligjit nr.9863, datë 28.1.2008, si më poshtë vijon:

a) Z. Shpëtim Nazarko, person publik nga fusha e medias;
b) Përfaqësues shkencorë të fushave të ushqimit, ushqimit për kafshë, veterinarisë dhe mbrojtjes së bimëve:

- Prof. Dr. Renata Kongoli (pedagoge në UBT, fusha e ushqimit);
- Prof. Dr. Dhimitër Rrapti (pedagog në UBT, fusha e veterinarisë);
- Prof. As.Dr. Lindita Molla (pedagog, fusha e sigurisë ushqimore);
- Prof. Dr. Lumturi Papa (pedagoge në UBT, fusha e ushqimit të kafshëve);
- Prof. Dr. Kapllan Sulaj (pedagog në UBT, fusha e ushqimit).

c) Znj.Nikoleta Dervishi përfaqësuese e shoqatave të konsumatorëve;

ç) Z. Agim Rameta, përfaqësues i shoqatave të agrobiznesit.

2. Vendimi nr.321, datë 5.5.2010, i Këshillit të Ministrave, “Për caktimin e disa anëtarëve të bordit të Autoritetit Kombëtar të Ushqimit”, shfuqizohet.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama